



**VENDIM**

**Nr. 110, Datë 07.09.2015**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË MESOPOTAM ENERGY SH.P.K. NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “DRIZA” (ME FUQI TË INSTALUAR 3.408 MW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, gërma “a” dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.09.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MESOPOTAM ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “MESOPOTAM ENERGY” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “MESOPOTAM ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “Driza” me fuqi të instaluar 3.408 MW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**